

**VENDIM****Nr. 306, datë 20.4.2016**

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E
PUNËVE TË BRENDSHME TË
AGJENCIA E OFRIMIT TË
SHËRBIMEVE PUBLIKE TË
INTEGRUARA (ADISA), TË MJEDISEVE
TË KATIT PËRDHE TË PRONËS ME
EMËRTIMIN “SHTËPIA E
USHTARAKËVE”, FIER, DHE PËR NJË
NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 250,
DATË 24.4.2003, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE
TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË
CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË
RENDIT PUBLIK”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Punëve të Brendshme tek Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), të mjediseve të katit përdhe, me sipërfaqe 396 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë) m², të pronës me emërtimin “Shtëpia e

Ushtarakëve”, me vendndodhje në Fier, për t’u përdorur si mjedise pune për ushtrimin e veprimtarisë administrative të ADISA-s, sipas formularit dhe planimetrisë që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Sipërfaqja prej 396 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë) m², e ndodhur në katin përdhe, pjesë e pronës me emërtimin “Shtëpia e Ushtarakëve”, me vendndodhje në Fier, e përcaktuar në pikën 1 të këtij projektvendimi, të hiqet nga listat e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore që i bashkëlidhet vendimit nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”, të ndryshuar.

3. Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) i ndalohej ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta japë me qira ose ta tjetërsojë atë.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**